

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në
Buletinin e Njoftimeve Publike)

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri: Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokaster Sh.A
Adresa: "Rr.Muharrem Gega "Nd.24, Hy. 1, Gjirokaster.
E-mail: ukgjirokaster@hotmail.com
Web-faqe: <https://www.shuk.al/gjirokaster/>

2. Lloji i procedurës së prokurimit: *Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar, sherbime*

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-96526-08-18-2026

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Studim Projektim Ujësjiellësi, për fshatrat e Bashkisë Memaliaj: Arrëz e Madhe, Maricaj, Vagalat, Tosk Martalloz, Dervishaj”.

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 22114311-5 - Projekte

6. Fondi limit: 19,209,148.44 (Nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e nëntë mijë e njëqind e dyzet e tetë lekë e dyzet e katër) lekë PA TVSH ose 206,394.63 EUR (Dyqind e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë e tre cent).

(Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 10.08.2026, 1 euro = 93.07 All).

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 55 (pesedhjetë e pese) dite

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 14.09.2026 ora 12:00

Në mbështetje të nenit 42, pika 6, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Autoriteti/Enti Kontraktor vlerëson të nevojshëm reduktimin e afatit për paraqitjen e ofertave në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, për procedurën me objekt “Studim Projektim Ujësjiellësi, për fshatrat e Bashkisë Memaliaj: Arrëz e Madhe, Maricaj, Vagalat, Tosk Martalloz, Dervishaj”.

Referuar Detyrës së Projektimit, një pjesë e fshatrave furnizohen me rrjete ujësjiellësi të degraduara dhe shumë të amortizuara, ndërsa në zona të tjera infrastruktura e furnizimit me ujë është e pamjaftueshme. Në rrjetet ekzistuese evidentohen edhe tubacione prej eterniti dhe hekuri, ndërsa ndërhyrjet e kryera ndër vite kanë qenë të pjesshme dhe nuk kanë siguruar zgjidhje të qëndrueshme për furnizimin me ujë 24 orë.

Studim–Projektimi synon hartimin e një zgjidhjeje të plotë dhe afatgjatë, duke përfshirë veprën e marrjes, linjën kryesore të furnizimit, depot e ujit, rrjetet shpërndarëse, pusetat e komandimit

dhe reduktimit të presionit, matësat e ujit, si dhe dimensionimin e sistemit për furnizim **24 orë/ditë** me perspektivë **25-vjeçare**.

Shërbimi përfshin analizën e Detyrës së Projektimit, Projekt-Idenë Paraprake, Projekt-Idenë Përfundimtare, Projektin e Zbatimit dhe Preventivin Përfundimtar, me një afat të përgjithshëm realizimi prej **55 ditësh**.

Për sa më sipër, nisur nga gjendja problematike e furnizimit me ujë, nevoja për fillimin në kohë të projektimit dhe vijimin pa vonesa me fazat e mëtejshme të investimit, Autoriteti/Enti Kontraktor vlerëson të arsyeshëm aplikimin e shkurtimit të afatit për pranimin e ofertave.

Dokumentet e tenderit do të publikohen dhe do të vihen në dispozicion në mënyrë elektronike, të plotë dhe pa kufizim për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, duke garantuar transparencë, trajtim të barabartë dhe konkurrencë efektive.

9. Procedurë e Rishpallur:

Po

☐

Jo

X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)